

20261552238

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 49 paragrafit (11) të Ligjit për Standardin Studentor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 15/13, 120/13, 41/14, 146/15, 30/16, 178/16, 64/18 dhe 20/19, si dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 124/19, 248/20, 302/20, 235/24 dhe 111/26), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RR E G U L L O R E PËR LLOJET E BURSIVE STUDENTORE DHE MËNYRËN E NDARJES SË BURSAVE STUDENTORE

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen llojet e bursave studentore dhe mënyra e ndarjes së bursave studentore.

Neni 2

Për bursë studentore (në tekstin e mëtejshëm: bursa), mund të konkurojë studenti i rregullt i regjistruar në studimet deridiplomike të ciklit të parë në universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me Konkursin e shpallur për ndarjen e bursave studentore për studentët e rregullt të regjistruar në studimet deridiplomike të ciklit të parë në universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Konkursi).

Neni 3

Studentët nga neni 2 i kësaj rregullore, plotësojnë aplikimin elektronik dhe bashkangjesin dokumentacionin përkatës në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) <https://e-uslugi.mon.gov.mk/>, sipas Konkursit të Ministrisë.

Neni 4

Ndarja e bursave sipas kategorive bëhet sipas mënyrës më poshtë:

a) Grupi i parë – 40% e numrit të përgjithshëm të bursave janë për studentët me vështirësi dhe sëmundje të rralla, të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

b) Grupi i dytë – 35% nga numri i përgjithshëm i bursave janë për studentët e regjistruar si studentë të rregullt në universitetet publike dhe private dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në programe studimore të cilat janë me interes strategjik për vendin;

c) Grupi i tretë – 25% e numrit të përgjithshëm të bursave janë për studentët e regjistruar si studentë të rregullt në universitetet publike dhe private dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët kanë arritur rezultate të shkëlqyera në mësim.

Neni 5

Renditja e studentëve të kategorive sociale dhe studentëve me vështirësi dhe me sëmundje të rralla nga neni 4 pika a) të kësaj rregullore, bëhet në mënyrën në vazhdim:

a) Studentët marrin pikë në bazë të suksesit të arritur në arsim dhe të gjendjes materiale të studentëve dhe familjeve të tyre.

b) Studentët të cilët deri në moshën 18-vjeçare kanë qenë pa prindër dhe pa kujdes prindëror, studentët – fëmijë të prindit vetëushqyes, studentët – fëmijë të përfituesve të ndihmës sociale dhe studentët – fëmijë të përfituesve të kompensimit për tepriçë teknologjike, për të cilët të ardhurat e përgjithshme të familjes janë nën pagën minimale neto të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, marrin 10 (dhjetë) pikë shtesë.

c) Në bazë të suksesit në mësim, përkatësisht suksesit të arritur gjatë studimeve, pikët llogariten sipas formulës së mëposhtme:

"Pikët nga suksesi i arritur = Nota mesatare (shuma e notave individuale e pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të notave)."

ç) Në bazë të gjendjes materiale të studentëve dhe familjeve të tyre, pikët përcaktohen në mënyrën më poshtë:

Gjendja familjare dhe materiale e studentit	Pikët
deri në 35% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	60
nga 36% deri në 45% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	50
nga 46% deri në 55% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	40
nga 56% deri në 65% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	30
nga 66% deri në 75% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	20
mbi 75% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut	0

d) Për kriterin e mundësive materiale të studentëve dhe familjeve të tyre, merren parasysh të ardhurat e përgjithshme mujore për anëtar të familjes së studentit (pagat mujore neto dhe të ardhurat vjetore sipas bazave të ndryshme të paraqitura në formularin e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, si: veprimtaria bujqësore, veprimtaria ekonomike, të drejtat e autorit, dhënia me qira e hapësirave dhe të ardhurave të tjera), në raport me pagën mesatare mujore neto të paguar për të punësuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për tre muajt e fundit, të përcaktuar nga Enti Shtetëror i Statistikës.

dh) Nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të ulëta ose të barabarta me 35% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 60 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 35%, ndërsa jua më të ulëta ose të barabarta me 45% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 50 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 45%, ndërsa më të ulëta ose të barabarta me 55% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 40 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 55%, ndërsa më të ulëta ose të barabarta me 65% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 30 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 65%, por më të ulëta ose të barabarta me 75% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 20 pikë, ndërsa për të ardhurat mujore të familjes për anëtar të cilat janë më të larta se 75% e pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk jepen pikë.

e) Të ardhurat e përgjithshme mujore për anëtar të familjes së studentit llogariten sipas formulës:

"Paga e fundit e paguar e babait +

Paga e fundit e paguar e nënës +

Paga e fundit e paguar e anëtarëve të tjerë të familjes +

Të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë ekonomike dhe profesionale (në nivel vjetor/12 muaj) për secilin anëtar të familjes veçmas +

Të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë bujqësore (në nivel vjetor/12 muaj) për secilin anëtar të familjes veçmas +

Të ardhurat nga pasuria dhe të drejtat pasurore (në nivel vjetor/12 muaj) për secilin anëtar të familjes veçmas +

Të ardhurat e tjera (në nivel vjetor/12 muaj) për secilin anëtar të familjes veçmas."

Shuma e përgjithshme e përfiturar në këtë mënyrë ndahet me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjes.

ë) Nëse ka më shumë kandidatë të paraqitur me numër të njëjtë pikësh, përparësi kanë kandidatët e regjistruar në vite më të lartë të studimeve.

Studentët me vështirësi dhe me sëmundje të rralla në nenin 4 pika a) të kësaj rregullore, fitojnë 100 pikë në bazë të vështirësisë ose sëmundjes së rrallë.

Neni 6

Studentët nga neni 4 pika b) të kësaj rregullore, të cilët janë të regjistruar në programe studimore me interes strategjik për vendin, marrin pikë për suksesin e arritur gjatë studimeve.

Në bazë të programit studimor në të cilin është i regjistruar studenti, pikët fitohen në bazë të formulës së mëposhtme:

"Pikët = Nota mesatare (shuma e notave individuale e pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të notave)."

Studentët të cilët janë të regjistruar në programe studimore të institucioneve të arsimit të lartë të kuadrit arsimor për grupin klasor në arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe arsimin e mesëm marrin 10 (dhjetë) pikë shtesë.

Nëse ka më shumë kandidatë të paraqitur me numër të njëjtë pikësh, përparësi kanë kandidatët e regjistruar në vitet më të lartë të studimeve.

Neni 7

Studentët nga neni 4, pika c) e kësaj rregullore, të cilët kanë arritur sukses veçanërisht të lartë në studimet e tyre, marrin pikë për suksesin e tyre gjatë studimeve.

Në bazë të suksesit të mësuarit, përkatësisht suksesit të arritur gjatë studimeve të tyre, pikët jepen në bazë të formulës në vazhdim:

"Pikët = Nota mesatare (shuma e notave individuale të ndarë me numrin e notave)".

Studentët të cilët marrin pjesë në Programin për ofrimin e mësimdhënies tutoriale për nxënësit e arsimit fillor, përkatësisht Programin për ofrimin e mësimdhënies tutoriale për nxënësit e arsimit të mesëm marrin 10 pikë shtesë.

Nëse ka më shumë aplikantë me të njëjtin numër pikësh, përparësi do t'u jepet kandidatëve të regjistruar në vitet më të lartë të studimeve të tyre.

Neni 8

Nga ministria:

- konfirmohet lista e programeve studimore me interes strategjik për vendin me propozim të Këshillit Kombëtar për Arsimin e Lartë,

- pranohet dhe kontrollohet dokumentacioni nga kandidatët,

- dorëzohet për miratim deri te ministri i Arsimit dhe Shkencës me listën përfundimtare të kandidatëve të cilëve u është ndarë bursa,
- përgatit listë përfundimtare të studentëve të cilëve u është ndarë bursa dhe e publikon në ueb-faqen e Ministrisë,
- njoftohen të gjithë kandidatët në bazë të përzgjedhjes nëpërmjet portalit të Ministrisë <https://e-uslugi.mon.gov.mk/>,
- dorëzohen ankesat në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurat Administrative, Procedurat e Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrjen e Inspektimit.

Neni 9

Studenti mund të aplikojë vetëm për një lloj burse.

Neni 10

Për bursat nga neni 4 pikat a) dhe c) të kësaj rregullore, bursat ndahen më së hershmi nga viti i dytë i studimeve, me përjashtim të studentëve me vështirësi dhe sëmundje të rralla.

Bursat ndahen për të paktën një vit akademik, ndërsa mund të vazhdohet për më së shumti aq vite akademike të studimeve deridiplomike të ciklit të parë sa janë të parashikuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë. Pas vitit të parë të shfrytëzimit të bursës, studenti ka të drejtë ta vazhdojë bursën nëse vazhdon t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në Konkurs.

Për bursat e parashikuara në nenin 4, pika b) të kësaj rregullore, si dhe për studentët me vështirësi dhe me sëmundje të rralla të përmendur në nenin 4, pika a), bursa mund të jepet që nga viti i parë i studimeve. Bursa ndahet për të paktën një vit akademik dhe më së shumti për aq vite akademike të ciklit të parë të studimeve sa janë të parashikuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë. Pas vitit të parë të shfrytëzimit të bursës, studenti ka të drejtë ta vazhdojë bursën nëse vazhdon t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në Konkurs.

Neni 11

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, pushon së vlefshmi Rregullorja për llojin e bursave studentore dhe mënyrën e ndarjes së bursave studentore për studentët të cilët studiojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 258/20, 160/21, 47/23 dhe 172/24).

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 19-9100/1
8.7.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr.Dr. **Весна Јаневска**, d.v.